

STATUTI

I SHOQERISE “ HIDROSANITARE SHABA ” SH.P.K.

Ne mbështetje të Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, si dhe të gjithë Legjislacionit Shqiptar në fuqi.

Sot me datë **24/01/2024** ortaket themelues:

1. **Z. Sindi SHABA**, atesia Fatlum, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë me 14/12/2002 dhe banues në Tiranë në Rrugen Jahja Ballhysa ,Nd. 34, Lunder, Tiranë
2. **Z. Gerald SHABA**, atesia Banush, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë me 06/02/2001, dhe banues në Tiranë në Rrugen Jahja Ballhysa ,Nd. 62 , Lunder, Tiranë

Te cilet hartojne kete statut te shoqerise “**HIDROSANITARE SHABA**” SH.P.K mbeshtetur ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “*Per tregtaret dhe shoqerite tregtare*“, ligjin 9723 date 03.05.2007 “*Per Qendren Kombetare te Regjistrimit*”, Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, (me poshte “Shoqeria”):

KAPITULLI I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Themelimi, Forma, Emertimi

1.1 Sot me date **24/01/2024** krijohet shoqeria “**HIDROSANITARE SHABA**” SH.P.K. Ky emertim eshte i vetmi i shoqerise dhe perdoret ne te gjithë regjistrimet, transaksionet, marreveshjet dhe komunikimet e saj me te tretet apo shtetin dhe eshte i vlefshem si jashte dhe brenda vendit.


1.2 Shoqeria “**HIDROSANITARE SHABA**” SH.P.K. eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, veprimtaria e te cilit do te rregullohet me ane te ketij Statuti dhe Aktit te Themelimit.

1.3 Shoqeria ka vulen dhe logon e saj identifikuese, ne formen dhe me ekstremitetet e caktuara nga ortaket e shoqerise.

1.4 Shoqeria vepron sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi.

1.5 Akti i themelimit dhe Statuti jane ne perputhje me legjislacionin shqiptar qe ka karakter te detyrueshem, ndersa ceshtjet qe nuk jane shprehimisht te parashikuar ne to, plotesohen nga legjislacioni shqiptar.

HIDROSANITARE SHABA



Neni 2

Themeluesi

Shoqeria themelohet nga shtetasit

- **Sindi SHABA**
- **Gerald SHABA**

Neni 3

Objekti i veprimtarise se shoqerise

3.1. Objekti i veprimtarise se shoqerise ne perputhje me legjislacionin tregtar aktual shqiptar do te jete:

- Tregti me pakice te artikujve Hidrosanitare dhe Hidraulike.
- Ne funksion te qellimeve te mesiperme Shoqeria mund te hyje ne tregje dhe operacione te ndryshme, te zoteroje pasuri te luajtshme e te paluajtshme dhe/ose pjesemarrje ne shoqeri te tjera tregtare. Shoqeria mundet gjithashtu te ushtroje cdo lloj tjetër biznesi apo aktiviteti te ligjshem dhe/ose mund te angazhohet ne cdo veprimtari te ligjshme ose aktivitet te lejueshem nga legjislacloni shqiptar ne fuqi per nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar.

3.2 Pershkrimi i objektit te shoqerise ka natyre indikuese dhe jo kufizuese. Per realizimin e qellimit te saj shoqeria mund te bashkepuoje me çdo person fizik apo juridik ne çdo menyre qe e gjykon te dobishme.

3.3 Shoqeria ne çdo kohe mund te ripercaktoje objektin e saj, ta shtoje apo pakesoje ate, me vendim te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise.

Neni 4

Selia e shoqerise dhe deget

4.1 Selia e shoqerise do te jete ne adresen: Njesia bashkiake nr. 2, Rr Mihal Grameno , Zona Kadrastale nr. 8160, Nr. Pasurie 3/1067 + N4, Kati i Pare nr. 4, Tirane

4.2 Transferimi i selise se shoqerise ne nje vend tjetër behet me vendim te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise.

4.3 Shoqeria ke te drejte te operoje me zyra, filiale, dege apo agjenci ne te gjithë territorin e Shqiperise apo edhe jashte shtetit.

4.4 Zyrat, filialet, deget apo agjencite krijohen me vendim te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise, i cili organizon punen dhe emeron organet drejtuese dhe perfaqesuesit e tyre ligjor.

Neni 5

Kohezgjatja e shoqerise

5.1 Kohezgjatja e shoqerise "**HIDROSANITARE SHABA**" sh.p.k eshte e pakufizuar.

5.2 Ky afat mund te ndryshohet ne çdo kohe me vendim te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise.

5.3 Shoqeria mund te priset ne cdo moment me vendim te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise.

KAPITULLI II

KAPITALI THEMELTAR

Neni 6

Kapitali themeltar

HIDROSANITARE SHABA

6.1 Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 (njqindmije) leke dhe perbehet nga 2 kuota

6.2.Ortaku themelues **Sindi SHABA** eshte zoterues i 1 kuote me vlere te pergjithshme 50.000 lek dhe qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise.

6.3. Ortaku themelues **Gerald SHABA** eshte zoterues i kuote me vlere te pergjithshme 50.000 lek dhe qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Neni 7

Ndryshimi i kapitalit themeltar

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre , nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, ecila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejtin mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

Neni 8

Fitimet qe realizohen gjate veprimtarise dhe qe konkretizohen me nxjerrjen e bilanceve periodike i perkasin ortakeve te shoqerise, por kurdohere pasi te jene shlyer detyrimet ligjore.

Neni 9

Shoqeria "**HIDROSANITARE SHABA**" sh.p.k eshte perdoruese dhe disponuese e pasurise se saj. Ajo mund te bleje e te shfrytezoje te drejta te tjera materiale ose jomateriale duke perfshire edhe te drejten e shites se pasurise se vet te te tretet.

Neni 10

Shoqeria "**HIDROSANITARE SHABA**" sh.p.k vepron ne regjimin e prones private dhe merr persiper te drejta e detyrimet vetem brenda kufirit te kapitalit te saj. Ortaket themelues te shoqerise mbartin rrezikun e veprimtarise se shoqerise vetem deri ne nivelin e kapitalit se investuar ne te.

Neni 11

Kuotat e kapitalit te shoqerise mund te fitohen apo kalohen nepermjet :

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) Shitblerjes
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit
- e) Çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj

HIDROSANITARE SHABA

KAPITULLI III

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Neni 12

Organi vendimmarres

12.1 Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise per ceshtjet e meposhtme

- Ndryshimin e Aktit te Themelimit dhe Statutit te shoqerise;
- Miratimin e buxhetit vjetor te shoqerise, te raporteve te administrimit, te inventareve dhe bilancit e llogarive vjetore te saj;
- Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar;
- Zgjedhjen e administratoreve dhe caktimin e detyrave e kompetencave te tyre, pervec atyre te percaktuara ne Statut;
- Aprovimin e garancive qe jep shoqeria;
- Miratimin e çmimeve dhe tarifave te mallrave apo sherbimeve qe ofron Shoqeria ne treg;
- Fillimin dhe nderprerjen e marredhenieve te punes me punemarresit e shoqerise;
- Caktimin dhe ndryshimin e shenjave dalluese te shoqerise si vula dhe logoja e saj;
- Mbikqyrjen e administratorit te shoqerise ne menyren se si ai kryen detyren e tij;
- Zhveshjen nga kompetencat te administratorit dhe kryerjen nga ana e tij te te gjitha veprimeve te administrimit te shoqerise ne emer dhe per llogari te saj;
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese;
- Çdo kompetence tjeter qe i jepet nga ligji tregtar.

Neni 13

Administrimi

13.1 Administratori i shoqerise emerohet per nje afat 5 (pese) vjecar:

1. Administrator i shoqerise i emeruar do te Z. Sindi SHABA , atesia Fatlum, shtetas Shqiptar, lindur ne Tirane me 14/12/2002 dhe banues ne ne Tirane ne Rrugen Jahja Ballhysa ,Nd. 34, Lunder, Tirane

Neni 14

Kompetencat e Administratorit

Administratori pervec detyrave qe i cakton Asambleja e Ortakeve te Shoqerise ka edhe keto te drejta e detyra te tjera:

- Te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga asambleja e pergjithshme, te mireadministroje pasurine e shoqerise;
- Te lidhe marreveshje me te tretet brenda objektit te veprimtarise se shoqerise dhe kompetencave te caktuara nga Asambleja e Ortakeve te Shoqerise;
- Te kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise.
- Te pergatise dhe te nenshkruaje bilancin vjetor , bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim.

HIDROSANITARE SHABA

- Te krijoje nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe e kercenojne mbarevajtjen e shoqerise dhe ekzistencen e saj.
- Kryejne regjistrime dhe dergojne te dhena te detyrueshme te shoqeerise sic parashikohet ne ligjin per QKB-it.
- Te kryeje detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

Neni 15

Pergjegjesite e Administratorit

Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise ose ndaj te treteve per shkelje te ligjeve, shkelje te statutit apo per faj te kryer gjate administrimit te shoqerise. Pavec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise sipas neneve 14,15,17 e 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", Administratori detyrohet:

- Te zbatoje rregulloren e brendshme te shoqerise;
- Te shperbleje demet qe i vijne shoqerise si pasoje e veprimeve apo mosveprimeve te tij;
- Te paguhet per punen e kryer ne baze te marreveshejs se bere midis tij dhe ortakeve te shoqerise.
- Te marre te dhena e te beje propozime mbi gjithshka qe ai e quan te dobishme per shoqerine;
- Te parandaloje dhe te menjenoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale mbi ata te shoqerise
- Te kryeje çdo detyre tjeter qe i ngarkohet nga Asambleja e Ortakeve te Shoqerise.

KAPITULLI IV

VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPERNDARJA E FITIMIT

Neni 16

Viti Financiar

Viti financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor te çdo viti.

Perjashtimisht Viti i pare financiar perfshin kohen nga data e regjistrimit te Shoqerise ne Rregjistrin Tregtar prane Qendres Kombetare te Rregjistrimit dhe perfundon ne 31 Dhjetor te te njejtit vit.

Neni 17

Inventari dhe llogarite vjetore

17.1 Shoqeria do te mbaje nje kontabilitet te rregullt te pasurise dhe te veprimtarise se saj, ne pajtim me kerkesat ligjore.



Ne mbyllje te vitit financiar, administratori harton inventarin e pasurise ne kete date dhe llogarite vjetore per vitin financiar.

Neni 18

Eksperti kontabel i autorizuar

18.1 Ne rast se kerkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Ortakeve te Shoqerise, kontrolli i bilaneve dhe librave kontabel te shoqerise mund t'i besohet nje eksperti kontabel te autorizuar.

HIDROSANITARE SHABA

18.2 Eksperti kontabel i autorizuar mund te shkarkohet sipas menyres se parashikuar nga legjislacioni ne fuqi

Neni 19

Raportet Vjetore

19.1 Ne mbylljen e çdo viti financiar Administratori dhe eksperti kontabel (nese eshte emeruar) ben inventaret dhe llogarite vjetore ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi per kontabilitetin si dhe harton nje raport me shkrim per ortaket e shoqerise.

19.2 Bilancit i bashkengjiten nje situacion mbi garancite e dhena nga shoqeria dhe nje situacion mbi sigurimet e bera nga shoqeria

19.3 Raporti pasqyron gjendjen e shoqerise gjate vitit financiar te kaluar, ndryshimet e parashikuara, veprimtarite e rendesishme, etj.

19.4 Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit kontabel te autorizuar (nese eshte emeruar) miratohen nga asambleja e ortakeve te shoqerise sipas ligjit 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare"

Neni 20

Rezultatet e vitit financiar dhe caktimi i fitimeve

20.1 Rezultati i vitit financiar percaktohet si diference ndermjet te ardhurave dhe shpenzimeve te ushtrimit, duke perfshire te keto te fundit amortizimet dhe provizionet.

20.2 Shuma e fitimeve te mbetura pas heqjeve per krijimin e rezervave perfaqeson dividendin, i cili i shperndahet.

20.3 Duke perjashtuar rastin kur eshte vendosur zvogelimi i kapitalit, nga fitimet e vitit financiar nuk behet asnje heqje dhe asnje derdhje dividenti, ne qofte se kapitalet e veta jane ose do te beheshin me te vogla se shuma e kapitalit themeltar plus shumen minimale te kerkuar per rezerven e domosdoshme.

20.4 Ne qofte se ekziston nje humbje, kjo mbartet per t'u perfshire ne fitimet e vitit financiar te ardhshme deri ne shuarjen e saj.

Neni 21

Rezerva e domosdoshme dhe e nevojshme

21.1 Nga fitimi i rezervuar gjate vitit financiar pasi zbriten humbjet e vitit te meparshem, hiqet menjane nje shume e barabarte me 5 % (pese perqind) e fitimit e destinuar per formimin e fondit rezerve te quajtur "rezerve e domosdoshme".

21.2 Heqja nga fitimet per rezerven e domosdoshme pushon se qeni e detyrueshme kur kjo rezerve arrin 10 % te kapitalit themeltar. Ajo rifillon kur per nje arsye çfaredo, rezerva e domosdoshme ka zbritur nen 10 % te kapitalit.


21.3 Ortaket e Shoqerise mund te vendosin edhe zbritje te vecanta ne favor te rezervave te jashtezakonshme ose per qellime te tjera apo dhe shtyerjen e shperndarjes se fitimeve, plotesisht apo pjesisht, per vitet financiare te ardhshme

Neni 22

Fitimi qe shperndahet

22.1 Koha, menyra dhe shuma e fitimit qe shperndahen vendoset rast pas rasti nga Asambleja e Ortakeve te shoqerise sipas raportit te administrimit ne perputhje me kete Statut, ligjin tregtar dhe gjendjen financiare te shoqerise.

HIDROSANITARE SHABA



KAPITULLI V

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 23

Likuidimi i shoqerise

23.1 Menjehere pas marrjes se vendimit per prishjen e shoqerise, Asambleja e Ortakeve te Shoqerise cakton nje likuidator, kompetencat e tij dhe menyren e likuidimit te shoqerise, ne perputhje me dispozitat perkatese te ligjit tregtar.

23.2 Likuidatori i emeruar nga Asambleja e Ortakeve te Shoqerise menjehere sapo merr detyren eshte i detyruar te publikoje bilancin e shoqerise duke specifikuar aktivin dhe pasivin dhe t'ia vene ne dispozicion menjehere Asamblese se Ortakeve te Shoqerise.

23.3 Me caktimin e likuidatorit pezullohen te gjitha kompetencat e Administratorit dhe ato i kalojne likuidatorit.

DISPOZITA KALIMTARE

Neni 24

Dispozita te fundit

24.1 Per te gjitha ceshtjet qe nuk gjejne rregullim ne kete Statut, aplikohen dispozitat e ligjit Nr.9901 dt 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare"

24.2 Per efekt te interpretimit te ketij Statuti me ligj tregtar nenkuptohet ligji Nr.9901 dt.14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

24.3 Pavlefshmerite eventuale te dispozitave te veçanta te Statutit nuk mund te cenojne vlefshmerine e tij.

Neni 25

Personaliteti juridik i shoqerise

Shoqeria fiton zotesine per te vepruar me regjistrimin e saj ne Rregjistrin Tregtar prane Qendres Kombetare te Biznesit

Neni 26

Gjykata kompetente

Gjykata kompetente per zgjidhjen e te gjitha mosmarrveshjeve midis ortakeve dhe interpretimin e statutit te shoqerise eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Neni 27

Hyrja ne fuqi

Ky Statut hyn ne fuqi dhe eshte i detyrueshem per zbatim ne momentin e firmosjes nga ortaket e shoqerise.

ORTAKET THEMELUES

TE SHOQERISE "HIDROSANITARE SHABA" SH.P.K

Z. Sindi SHABA

Sindi Shaba

Z. Gerald SHABA

Gerald Shaba

HIDROSANITARE SHABA